



RÖFIX AS 345

Optiseal® 1K Hidroizolues 1K

Udhëzime teknike dhe ligjore:

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.


Fushat e përdorimit:

Masë izoluese një komponentsh me bazë çimento sipas EN 14891 - CM 01P.
Për izolimin dhe eliminimin e krisjeve në sipërfaqen e dyshemesë, ku mund të ketë ose jo rrjedhje të vazhdueshme të ujrave, për shtrimin e brëndshëm të rezervateve të ujit të përditshëm deri në një thellësi prej 4m, ashtu dhe izolimin e trupave të betonit (EN 206-1 / DIN 1045-2, klasa e ekspozimit XA2).
Ngjitës izolues për ballkone, tarraca, dushe, lavanderi, tualete, ashtu edhe pishinina me ujë deti deri në max. 3,9% përmbajtje kripe, të cilat më pas mbulohen me një shtresë qeramike, ashtu dhe për restaurimin e shtresave të vjetra qeramike, të dëmtuara, mbajtëse në ballkone dhe tarraca. I përshtatshëm edhe për tarracat e banuara me finiturë qeramike.
Jo e përshtatshme për izolimin e avujve (frenon avujt dhe ujën)

Karakteristikat:

- Elastik, fleksibël
- Mbulon të çarat
- Mbulon të çarat
- Përpunim i mirë me makineri
- I papërshkueshëm nga uji, por I hapur për difuzion.
- Me qëndrueshmëri ndaj temperaturave dhe vjetërsimit
- Ngjit edhe mbi Bitum
- rezistent ndaj UV

Përpunimi:



Baza e materialit:

- Çimento
- Rvshirw akrilike
- Aditivë shtesë për përmirësimin e aftësisë së përpunimit

Kushtet e punimit:

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C.
Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.
Temperaturat e ulëta sikurse lagështia e madhe zgjasin kohën e tharjes.

Bazamenti:

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, të ketë aftësi mbajtëse si edhe të mos ketë papastërti (si p.sh. pluhur, alga, blözë, etj.).
Për shkak të strukturës të shumanëshme të objektit, izolimi me RÖFIX Optilastic në zonat e pishinës, lejohet vetëm i ndërlidhur me survejimin paraprak të objektit dhe me rezultatet e aplikimit provë.
Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, të ketë aftësi mbajtëse si edhe të mos ketë papastërti (si p.sh. pluhur, alga, blözë, etj.).
Bazamenti lejohet të shfromohet brënda një kufiri të caktuar mbas shtrimin të izoluesit dhe duhet të përkojë me normat ekzistuese.



ROFIX AS 345

Optiseal® 1K Hidroizolues 1K

Bazamenti-Trajtimi paraprak:

Pjesë të lirshme dhe cipat e cimentos duhet të largohen me anë të zmerilimit dhe metoden e rezatimit me rërë.

Shtresat shumë absorbuese, çimentoja duhet të lyhet me astar të përshtatshëm (ROFIX AP 300). Koha e tharjes së sipërfaqes duhet të respektohet të paktën 24 orë.

Para shtrimit të Optilastic, bazamentet e betonit duhet të lagen mirë me ujë, ndërkohë që gjatë shtrimit të Optilastic sipërfaqja duhet të jetë e lagur mat. Te mënjanohet krijimi i pellgjeve!

Bazamentet me aftësi të mëdha thithëse duhet të shtrohen paraprakisht me (ROFIX AS 341 Optilastik 1:1 te hollur) dhe gjatë këtij procesi në bazamentet me permbajtje gipsi, duhet respektuar një periudhë tharje prej 24 orësh .

Përgatitja:

Komponenti pluhur A me komponentin B duhet miksuar plotësisht me një perzjeres mekanik, për të përfutur një masë homogjene pa kokërriza.

Këshilla:

Për shkak të strukturës të shumanëshme të objektit, izolimi me ROFIX Optilastic në zonat e pishinës, lejohet vetëm i ndërlidhur me survejimin paraprak të objektit dhe me rezultatet e aplikimit provë.

Të dhënat teknike janë përcaktuar sipas kushteve standarte.

Për çdo mm trashësi shtrese e thatë është e nevojshme një shtresë rreth 1,1mm trashësi shtrese e lagësht. Kjo duhet llogaritur sipas trashësisë përkatëse të çdo shtrese.

Sipërfaqet e trajtuara me ROFIX AS 345 Optiseal (mure apo dysheme) mund të shtrohen mbas 24 orësh, në varësi të temperaturës së objektit dhe ambientit, shtresat qeramike me ROFIX C2-Ngjithës pllakash(sipas EN 12004). Shtrimi i shtresave qeramike duhet të vijojë duke marrë parasysh rregullat e aplikimit sikurse dhe prospektet e shoqatës qendrore të ndermarjeve të ndërtimit

Këshilla në rast reziku:

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Magazinimi:

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri.

Koha e magazinimit min. 12 muaj, sipas Rregullores 1907/2006/EG Aneksi XVII në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambientit. Datën e prodhimit shiheni mbi etiketë.

Deklaratë:



Këshilla të përgjithshme:

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme.

Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme.

Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në veteve nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme.

Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona.

Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd.

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.